



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 16 korrik 2012  
Nr.ref.:AGJ/278/12

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KI47/12**

Parashtruesi

**Islam Thaçi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr.  
188/2009, të 7 dhjetorit 2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Ivan Čukalović, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Islam Thaçi, me vendbanim në Gjilan.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 188/2009 i 7 dhjetorit 2011, që parashtruesit i është dorëzuar më 13 janar 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 188/2009 të 7 dhjetorit 2011, që ka të bëjë me Vendimin 119/07 të Kuvendit Komunal në Kamenice, me të cilin parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 4 maj 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 22 maj 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 47/12, caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. 47/12, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Snezhana Botusharov (kryesuese), 2. Ivan Čukalović (anëtar) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).
7. Më 30 maj 2012, Gjykata, njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe Kuvendin Komunal në Kamenicë për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 47/12 caktoi gjyqtar raportues, gjyqtarin Altay Suroy, që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, meqë ajo përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 47/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Snezhana Botusharova (kryesuese) 2. Ivan Čukalović (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtare), që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, që po ashtu e përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012.
9. Më 11 korrik 2012, Gjykata shqyrtoj dhe votoi për rastin.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 6 qershor 2007 Kuvendi Komunal në Kamenicë, me Vendimin nr. 119, në cilësinë e punëdhënësit e kishte shkarkuar parashtruesin nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv. Parashtruesi kishte lidhur kontratë me nr.03/2007, me kohëzgjatje prej 31 janarit 2006 deri më 31 janar 2008. Kundër këtij Vendimi i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK), pasi që organi i punësimit nuk i ishte përgjigjur ankesës së tij të cilën e kishte parashtruar në afat ligjor.
11. Më 15 qershor 2007, paralelisht me ankesën parashtruar në KPMSHCK, parashtruesi kishte ushtruar padi edhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e

mëtejme: Gjykata Supreme) për shkak të heshtjes administrative nga ana e KK në Kamenicë.

12. Më 25 qershor 2007, parashtruesi serish kishte kërkuar nga KK në Kamenicë, që ti kthehej përgjigja lidhur me ankesën që e kishte parashtruar më 15 qershor 2007.
13. Më 27 gusht 2007, KPMSHCK, nxori Vendimin nr. 123/08 dhe aprovoi pjesërisht Ankesën e parashtruesit nr. 1341 të 15 qershorit 2007, duke i rekomanduar KK në Kamenicë që brenda tridhjetë (30) ditësh të veproi në përputhje me rekomandimet e dhëna në vendim, ku ndër të tjera thuhej:

*“Kuvendi Komunal në Kamenice gjate shkarkimit të Kryeshefit Ekzekutiv nuk ka zbatuar procedurat të cilat janë të parapara me aktet në fuqi. KK është dashtë të formoi një Komision i cili do të bënte vlerësimin e gjertanishëm të punës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe i cili do t'i raportoi-propozoi kuvendit për të gjeturat nga vlerësimi dhe Kuvendi të vendose (për shkarkim, apo jo) në bazë të procedurave të Rreg. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave në Kosove, neni 30.8, Rreg. të SHCK-2001136 neni 1, Urdh. Adm. 2003/2, UNMIK neni 2, Këshillën Ligjore të dhënë nga MPL, Nr. 2006/01 të dt. 25.04.2006, veçanërisht kapitulli IV pika 6, Këshilla Ligjore Nr. 2007/02 e dt. 13.02.2007 MPL kapitulli IV. Pika 5, si dhe interpretimi i OS BE se i dt. 09. Maj 2007 në lidhje me kontratat e Kryeshefave të Ekzekutivit dhe Drejtoreve në Drejtoritë në Komuna pika 9. po ashtu nuk është vepruar në bazë të nenit 52 pika 2 dhe 3 e Statutit Komunal.*

*3. Afati i përmbushjes së këtij vendimi nga KK. Kamenice është 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.*

*4. Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.*

*5. Ne rast mosveprimi sipas këtij vendimi KPMK do të njoftoje PSSP dhe Kryeministrin e Kosovës, në përputhje me nenin 11.4 të Rregullores 2001/36 mbi SHCK për ndërmarrjen e masave të mëtejme.”*

14. Duke qenë se, KK në Kamenicë, po e zvarriste zbatimin e vendimit të KPMSHCK parashtruesi, më 10 tetor 2007 ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë, me ç'rast kishte kërkuar anulimin e vendimit nr. 119 të Kryetarit të KK të Kamenicës lidhur me largimin e tij nga puna.
15. Më 28 janar 2008, Gjykata Komunale në Kamenicë, nxori Aktvendimin nr.vep.C. 112/07 më ç'rast vendosi t'i ndërpresë të gjitha procedurat lidhur me kontestin, gjersa KK në Kamenicë të vendoste sipas vendimit nr. 123/08 të KPMSHCK. Parashtruesi i pa kënaqur me këtë vendim, ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.
16. Më 14 shkurt 2008 Kryetari i Komunës së Kamenicës dhe Menaxheri i Personelit përmes Njoftimit nr. 94/2008 informuan KPMSHCK për rastin, duke pranuar faktin që Vendimi për shkarkimin e Kryeshefit Ekzekutiv ishte miratuar në kundërshtim me aktet ligjore. Por edhe përkundër këtij fakti KK në Kamenicë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me kthimin e parashtruesit në pozicionin e mëparshëm të Kryeshefit Ekzekutiv.
17. Më 6 mars 2008, pasi që Gjykata Komunale në Kamenicë me Aktvendimin nr.vep.C. 112/07 kishte ndërprerë të gjitha procedurat lidhur me çështjen, parashtruesi, përmes një parashtrëse kërkoj nga e njëjta vazhdimin e proceduarave të pezulluara, pasi që KK në Kamenicë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk kishte vendosur ende për çështjen sipas vendimit të KPMSHCK .

18. Më 13 qershor 2008, Gjykata Komunale në Kamenicë, nxori Aktvendimin nr.vep.C. 74/2008, përmes së cilit shpalli veten jo kompetente për vendosjen e çështjes. Kjo gjykate kishte konstatuar që vendimi nr. 119/08 i 6 qershorit 2007 i kryetarit të KK të Kamenicës lidhur me shkarkimin e Kryeshefit Ekzekutiv është akt administrativ, dhe se për këtë çështje me vendimin nr. 123/08 kishte vendosur KPMSHCK si organ i shkallës së dytë, i cili vendosi t'ia kthente lëndën KK të Kamenicës për rishqyrtim që të vendoste sipas rekomandimit të KPMSHCK.
19. Më 12 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut në Gjilan, nxori Aktvendimin Ac. nr 308/2008 dhe refuzoi si të pa bazë ankesën e ushtruar nga parashtruesi, duke vërtetuar kështu Aktvendimin C.nr.74/2008 të Gjykatës Komunale të Gjilanit të 13 qershorit 2008. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi më 14 janar 2008, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
20. Më 8 janar 2009, Gjykata Supreme, nxori Aktgjykimin A. nr. 218/2007, aprovoi padinë e parashtruesit si të bazuar, më ç'rast kishte urdhëruar KPMSHCK që në afat prej tetë (8) ditësh të vendoste lidhur me ankesën e parashtruesit, pasi që me nenin 26 të Ligjit për Konfliktin Administrativ është parapare që organi i shkallës së dytë duhet të vendos lidhur me ankesën në afat prej 60 ditësh, nga dita e parashtrimit të saj, nëse edhe pas 7 ditësh organi i shkallës së dytë nuk bie aktvendim lidhur me çështjen pala ka të drejt të inicioi kontest gjyqësor sikurse ankesa/kërkesa e tij të ishte refuzuar.
21. Më 7 dhjetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin Rev. nr.188/2009, me ç'rast refuzoi revizionin e ushtruar nga parashtruesi, duke u arsyetuar se në bazë të nenit 11 të Ligjit për Procedurën Administrative, Gjykata, është kompetente të vendosë për kërkesat e dorëzuara nga personat fizik dhe juridikë, mirëpo, duke qenë se KK në Kamenicë nuk ka vendosur ende për këtë çështje juridike, procedura administrative nga e njëjta është konsideruar si e pa përfunduar pasi që KK në Kamenicë nuk kishte vendosur ende sipas vendimit të KPMSHCK.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, si pasoje e moszbatimit të Vendimit nr.123/02 të KPMSHCK dhe refuzimit të vendosjes se çështjes se tij në baza meritore, të gjitha instancat gjyqësore, kanë bërë shkeljen e të drejtave kushtetuese të garantuara me: Nenin 22.1 [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], Nenin 31.1 [ E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm], Nenin 32 [ E Drejta për Mjete Juridike], Nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

23. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.
24. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi i kërkesës, është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë në pajtim me kërkesat e Nenit 113 dhe 113.7 të Kushtetutës. Parashtruesi, ka dorëzuar kërkesën e tij në pajtim me këto dispozita kushtetuese. Andaj, rezulton që i njëjti është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë për mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të tij.
25. Gjithashtu, parashtruesi, duhet të provoj që i ka përmbushur kërkesat e Nenit 49 të Ligjit, sa i përket dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i

Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 188/2009 i 7 dhjetorit 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 13 janar 2012. Parashtruesi, kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 4 maj 2012, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4 muajor të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

26. Gjykata, po ashtu përcakton nëse parashtruesi ka provuar ti ketë përmbushur kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Parashtruesi, fillimisht ka shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit, ka vazhduar me tej kërkesën për realizimin e të drejtës së tij në KPMSHCK, dhe më pas ka iniciuar kontest të punës sipas procedurës civile kontestimore në të gjitha instancat gjyqësore deri te mjeti i fundit juridik, që në rastin konkret është Aktvendimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009 i 7 dhjetorit 2012, Gjykata, konsideron që, parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi në kërkim të zgjidhjes së çështjes.
27. Gjithashtu, Gjykata, përcakton nëse parashtruesi në kërkesën e tij ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta kushtetuese pretendon t'i jenë shkelur, më cilin akt dhe nga cili autoritet publik. Parashtruesi, ka përmbushur edhe ketë kriter duke përmendur saktësisht shkeljet e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe po ashtu autoritetin publik që e konsideron shkelësin e këtyre të drejtave.
28. Pasi që parashtruesi është palë e autorizuar, ka përmbushur afatin e nevojshme për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe ka saktësuar me përpikëri dispozitat e shkeljes së të drejtave dhe lirive, përfshirë edhe autoritetin publik qe ka bërë shkelje, Gjykata, konstaton se, parashtruesi ka përmbushur të gjitha kriteret procedurale për pranueshmëri.

#### **Vlerësimi kushtetues i kërkesës**

29. Përderisa parashtruesi, ka plotësuar të gjitha kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata, duhet të gjykojë themelësinë e kërkesës së parashtruar në baza meritore.
30. Gjykata, nga parashtruesit, vëren se parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009 të 7 dhjetorit 2012, për shkak refuzimit të kërkesës së tij që kishte të bënte me zgjidhjen e kësaj çështje juridike (kontestit të punës), mes tij dhe KK të Kamenicës.
31. Siç duket nga shkresat e lëndës, fillimisht Gjykata Komunale në Kamenicë me Aktvendimin nr. vep. C. 112/07 kishte ndërprerë të gjitha procedurat lidhur me rastin dhe më pas me Aktvendimin nr.vep.C. 74/2008 e kishte shpallur veten jo kompetente për zgjidhjen e çështjes së parashtruesit. Ky vendim u vërtetua gjithashtu edhe nga Gjykata e Qarkut në Gjiilan. Këto instanca gjyqësore, kishin nënvizuar faktin që zgjidhja e rastit është kompetencë e KPMSHCK, dhe se kjo çështje nuk ishte vendosur ende nga KK në Kamenicës. Parashtruesi, duke qenë i pakënaqur me vendimet e këtyre instancave gjyqësore kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme, e cila po ashtu kishte nënvizuar faktin që zgjidhja e kontestit është kompetencë e KPMSHCK.
32. Nga sa më lartë, duket qartë se, parashtruesi i kërkesës, ka konsumuar të gjitha rrugët ligjore dhe institucionale, në kërkim të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të tij në kuptim të zbatimit të vendimit nr. 123/08 të KPMSHCK, që ishte lëshuar në përputhje me procedurat e parapara administrative. Mirëpo, edhe përkundër përpjekjeve të shumta të parashtruesit, për realizimin e kësaj të drejte të fituar me vendimin e lartpërmendur, përpjekjet e tij nuk u morën seriozisht nga autoritetet e KK të Kamenicës dhe autoritetet gjyqësore.



33. Si pasojë e mos vendosjes së çështjes nga KK i Kamenicës dhe refuzimit të zgjidhjes së saj edhe nga të gjitha instancat gjyqësore, parashtruesi i kërkesës, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 42.7 të Ligjit, duke e pare si mundësi të fundit realizimin e të drejtës së tij, më 14 maj 2012 parashtroi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
34. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës që nënvizon faktin se:
- “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*
35. Gjykata, vëren se, zgjidhja e kësaj çështjeje juridike, në rastin konkret, natyrisht që ka qenë kompetencë e KPMSHCKN, për faktin që pozita e Kryeshefit Ekzekutiv, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ka filluar të zbatohet në vitin 2004 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike i përkiste pikërisht këtij organi të pavarur.
36. Duke pas parasysh faktin që, natyra e punës, së parashtruesit, ka kërkuar zgjidhje të përshpejtuar nga një organ kompetent, për faktin që procedurat e zgjidhjes së këtyre kontesteve, kërkojnë ndërmarrjen e verimeve konkrete dhe efikase. Andaj, ky fakt është dashur të merrej parasysh, si nga KK i Kamenicës, po ashtu edhe nga gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, sepse duket qartë se parashtruesit nga të gjitha këto autoritete iu pamundësua realizimi i të drejtës që e kishte fituar me vendimin e KPMSHCK.
37. Komunitet e Republikës së Kosovës, duhet ta shohin si obligim Kushtetues zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe të autoriteteve publike, e jo ti zvarrisin procedurat e përmbartimit të tyre. Aq me tepër, kur procedurat përkatëse administrative që rregullohen me Ligj të posaçëm (*lex specialis*), dispozitat e të cilit në mënyrë të përshpejtuar parashohin zgjidhjen e këtyre çështjeve juridike, duke parapare edhe afatet kohore për zgjidhjen e tyre (*shih, paragrafin 13 të këtij aktgjykimi, rekomandimi i KPMSHCK, pika 3 e pjesës operative të vendimit nr. 123/08 i 27 gushtit 2007*), për faktin që natyra e tyre kërkon ndërmarrjen e veprimeve të tilla, zgjidhje të shpejtë dhe para se gjithash është në interes të shtetit që nëpunëseve që kategorizohen si “shërbyes civilë” t’u siguroj dhe garantoje mbrojtje gjyqësore të të drejtave ligjore dhe Kushtetuese, nga shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre nga ana e autoriteteve publike ku ata ushtrojnë profesionin e tyre.
38. Gjykata, vëren se, në rastin e parashtruesit, nuk ka qëndruar asnjë arsye e fortë dhe e qëndrueshme e autoriteteve të KK të Kamenicës për zvarritjen e procedurës lidhur me zbatimin e vendimit të KPMSHCK. Autoritetet e KK të Kamenicës, duke mos i venë në lëvizje mekanizmat për zbatimin e vendimit në fjalë, kanë dështuar të provojnë se janë të gatshme t’i respektojnë vendimet e një organi të pavarur dhe kompetent për vendosjen e kësaj çështjeje, aq me tepër kur të gjitha instancat gjyqësore e kishin adresuar zgjidhjen e saj tek ky organ (KPMSHCK).
39. Për më tepër, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr.188/2009 të 7 dhjetorit 2011, kishte konstatuar që zgjidhja e kësaj çështjeje juridike është nën juridiksionin e plotë të KPMSHCK. Prandaj, duke qenë se KK në Kamenice nuk po e zbatonte vendimin e KPMSHCK, kur dihet që kjo gjykatë, kishte konstatuar që KPMSHCK duhej të vendoste për rastin në fjalë në afatin e parapare me ligj (*shih: Aktgjykimin A nr. 218/2007 të 8 janarit 2009 të Gjykatës Supreme, ku e njëjta i kishte rekomanduar KPMSHCK që brenda afatit prej tetë (8) ditësh të vendoste për çështjen*).

40. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese, thekson që, Gjykata Supreme, duke ditur që parashtruesi po kërkonte mbrojtje gjyqësore të të drejtave ligjore dhe Kushtetuese, nga shkakut se KK në Kamenicë nuk po vepronte sipas vendimit të KPMSHCK, në këtë mënyrë e Gjykata Supreme anashkaloi ankesën/kërkesën e parashtruesit duke u mjaftuar me faktin që KK i Kamenicës ende nuk kishte vendosur për çështjen në procedurës administrative sipas rekomandimit të KPMSHCK.
41. Duke qenë se KPMSHCK, nxori vendim dhe i njëjti nuk po zbatohet nga KK i Kamenicës, ku ishte konstatuar që largimi nga puna i Kryeshefit Ekzekutiv të KK të Kamenicës ishte në kundërshtim me aktet ligjore, shtrohet pyetja, ku tjetër do duhej kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave për shkeljet që bëjnë autoritetet publike me veprimet ose mosveprimet e tyre.
42. Prandaj, Gjykata Supreme, duke e hedhur përgjegjësin për zgjidhjen e çështjes, tek KK në Kamenicës dhe KPMSHCK, ka bërë që parashtruesi të mbetet pa ndonjë rezultat konkret nga Gjykata Supreme, sepse parashtruesi nuk ka realizuar të drejtën e tij, nga shkakut se ati nuk i është ofruar “mbrojtje gjyqësore e të drejtave” siç parashihet me kërkesat e nenit 54 të Kushtetutës. Ndërsa, bartja e përgjegjësisë nga kjo instancë dhe adresimi i zgjidhjes së rastit në KPMSHCK, nuk mund të konsiderohet si arsyetim për refuzimin e shqyrtimit të ankesës së parashtruesit, pasi që ky organ i pavarur kishte nxjerr vendim konform procedurave administrative, siç kishte konstatuar më pas edhe vete Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr.188/2009 të 7 dhjetorit 2011. Por që ky vendim i KPMSHCK nuk është zbatuar asnjëherë nga KK i Kamenicës.
43. Në të vërtetë, duket qartë se parashtruesit i është pamundësuar, shfrytëzimi i mjeteve efektive juridike, prandaj, Gjykata Kushtetuese, vlerëson që, mos marrja parasysh e këtyre fakteve të rëndësishme është në kundërshtim të plotë me kërkesat e Nenit 32 të Kushtetutës.
44. Për ta bërë edhe më të qartë, këtë konstatim, Gjykata Kushtetuese, i referohet Nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që përcakton se: *“Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare.”*
45. GJEDNj ka nënvizuar se, Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë e një mjeti ligjor, në nivelin kombëtar, për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çdo lloj forme që mund të jetë parashikuar në rendin e tyre të brendshëm juridik. Efekti i Nenit 13 në këtë mënyrë kërkon ofrimin e mjeteve të brendshme juridike për të trajtuar përmbajtjen e një “ankimi të argumentueshëm” sipas Konventës dhe për të dhënë kompensimin e duhur (*shih Kudla k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 157, ECHR 2000 XI*). gjithsesi, mjeti juridik i Nenit 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë dhe në ligj (*shih, për shembull, İlhan k. Turqisë [GC], nr. 22277/93, § 97, ECHR 2000-VII*). më lart, § 158).
46. Nga e gjithë kjo, Gjykata Kushtetuese, ka kuptuar që, vendimi i KPMSHCK nuk ka gjetur zbatim tek autoritetet e KK të Kamenicës. Ankesat e parashtruesit që i ishin adresuar KK të Kamenicës që të përgjigjej lidhur me zvarritjen e procesit të vendimmarrjes, nuk u morën parasysh gjithashtu edhe nga instancat e rregullta gjyqësore. Si rezultat i këtyre anashkalimeve ose neglizhencës së autoriteteve publike, parashtruesi në asnjë mënyrë nuk ka realizuar të drejtën për mjete efektive juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.
47. Ndërsa, sa i përket qartësisht të pozicionit dhe juridiksionit të KPMSHCK Gjykata, konsideron që, KPMSHCK tani është institucion i pavarur i konstituuar me ligj, në

pajtim më Kushtetutën (shih, nenin 101.2 të Kushtetutës). Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet tjera përkatëse ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë duhet të përmbahet nga gjykata kompetente sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizimit të së drejtës së fituar në procedure administrative.

48. Neni 6 i Konventës zbatohet edhe për fazat administrative të procesit gjyqësor gjegjësisht është brenda kornizave “për të drejtën në Gjykim të drejte dhe të paanshëm” e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga kjo rrjedh se edhe moszbatimi i vendimeve të Këshillit është element i nenit 6 të Konventës dhe shkelje e saj.
49. Gjykata Kushtetuese thekson se, është e drejte e palës së pakënaqur që te inicioi procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të së drejtës së fituar që parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Do të ishte e pakuptimtë, nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar, i formës së prerë, të mbetet i paefektshëm në dem të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj gjykatës. Prandaj, jo efektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih: *mutatis mutandis, vendimin e GJEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtrës nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004*).
50. Gjykata është e mendimit se, ekzekutimi i një vendimi të marre nga një gjykate duhet shikuar si pjese përbërëse e të drejtës për gjykim të drejt, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura (shih: *mutatis mutandis, rastin Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f 510, para. 40*). Në rastin konkret, parashtruesi nuk do të duhej privuar nga përfitimi i vendimit të formës së prerë, që është në favorin e tij. Asnjë autoritet nuk mund të arsyetoj mos zbatimin vendimeve për qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih: *mutatis mutandis Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX*). Autoritetet kompetente, pra, kanë për obligimin që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të pa nevojshme (shih: *mutatis mutandis, Peceve kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006*).
51. Si përfundim, Gjykata Kushtetuese, konstaton se, moszbatimi i vendimit nr. 123/2008 të KPMSHCK dhe zvarritja e paarsyeshme e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike, nga autoritetet e KK të Kamenicës përbën shkelje të Nenit 31 në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës, si dhe Nenit 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës. Ndërsa, dështimi i autoriteteve gjyqësore dhe pamundësia e krijimit të rrethanave për “mjete efektive juridike” dhe “mbrojtje gjyqësore të të drejtave” ka bërë që gjykatat të lëshojnë vendime me shkelje të Nenit 32 në lidhje me Nenin 54 të Kushtetutës, Nenit 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA SHPALLË Kërkesën të pranueshme;
- II. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin Rev. nr. 188/2009, të Gjykatës Supreme, të 7 dhjetorit 2011, që shkel nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së;
- III. TA KTHEJË Aktvendimin Rev. nr. 188/2011 të Gjykatës Supreme, të 7 dhjetorit 2011 për shqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës, sipas nenit 74 (1) të Rregullores së punës; dhe
- IV. Në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, Gjykata Supreme do ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.
- V. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
- VI. Ky Aktgjykim do të ketë efekt të menjëhershëm.

**Gjyqtari Raportues**

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy, d.v.



Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.